



Data: 14/08/2019

Ref.: 1445/19 D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit në Kolegjin Tempulli: për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Inxhinieria e Transportit dhe Infrastruktura Rrugore, BSc, 180 ECTS
 - Inxhinieria e trafikut dhe siguria rrugore, MSc, 120 ECTS
- II. Nuk akreditohet programi i studimit:
 - Efiçenca e energjisë dhe ambienti, BA profesional
- III. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Kolegjit Tempulli për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

- I. Kolegji Tempulli ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitivin të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën e akreditimit në Kolegjin Tempulli më datë 25.06.2019 me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Dr. Clive Pidgeon dhe Prof. Dr. Gabor Dombay.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2019 dhe 26.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Tempulli dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket programit të studimit Inxhinieria e Transportit dhe Infrastruktura Rrugore, BSc, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit kanë konstatuar se ky program i studimit plotëson substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Gjithashtu, lidhur me programin e studimit Inxhinieria e trafikut dhe siguria rrugore, MSc, ekspertët kanë konstatuar se edhe ky program plotëson substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit.

Sa i përket programit të studimit Efiçenca e energjisë dhe ambienti Bachelor profesional, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit kanë konstatuar se ky program i studimit plotëson pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Ekspertët kanë konstatuar se nga gjithsej shtatë (7) kapitujt të standardeve të Manualit të Akreditimit, Kolegjit Tempulli për këtë program të studimit plotëson 1 plotësisht, 2 substancialisht dhe 4 prej tyre pjesërisht, dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar mosdhënien e akreditimit. Ekipi i ekspertëve ndër të tjera ka konstatuar këto mangësi të cilat kanë qar në mosdhënien e akreditimit: sipas ekspertëve misioni i programit Efiçenca e energjisë dhe ambienti nuk është plotësisht në përputhje me deklaratën e misionit të Kolegjit. Sipas ekipit të ekspertëve ky program me tri specializime është një përzierje e dy fushave profesionale të cilat ekipi i ekspertëve nuk mendon se mund të shkrihen në një program. Sa i përket kapitullit të standardeve që ka të bëjë me stafin akademik ekspertët kanë gjetur se prej tre bartësve të programit vetëm njëri është relevant për programin.


Ekipi i ekspertëve konsideron se programi në fjalë i propozuar me tri specializime në të vërtetë përmban në vete dy programe Efiçenca e energjisë dhe energjitë e ripërtrishme mund të konsiderohet si një disiplinë, kurse mbrojtja e ambientit është një disiplinë tjetër. Këto dy disiplina nuk duhet të përfshihen në të njëjtin program bachelor profesional pasi që kanë parakushtet të ndryshme. Sa i përket infrastrukturës gjatë vizitës ekipi i ekspertëve ka vërejtur se Kolegji tempulli posedon një laborator bazik për Efiçencë të energjisë mirëpo për specializimin që ka të bëjë me mbrojtjen e ambientit ekspertët nuk kanë gjetur se Kolegji ka laborator apo pajisje adekuate dhe si rezultat kanë konstatuar se infrastruktura e Kolegjit nuk ofron kushte për këtë specializim. Po ashtu ekipi i ekspertëve ka konstatuar se Kolegji Tempulli posedon një bibliotekë relativisht të vogël dhe me numër të kufizuar të materialeve mësimore. Ekipi i ekspertëve nuk ka hasur në asnjë libër nga fusha e efiçencës së energjisë apo fusha tjera relevante për programin e dhënë.

Në bazë të këtyre të gjeturave, ekipi i ekspertëve nuk ka dhënë rekomandim pozitiv për akreditim të programit të studimit Efiçenca e energjisë dhe ambienti BA profesional.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Tempulli;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë